2 thënë nga dikush se çfarë ka ndodhur, çfarë ka ndodhur në  
3 diskutimin që nuk ka qenë i pranishëm dëshmitari. Dhe mund të  
4 ndodhë ndoshta që ndonjë gjë ka humbur gjatë përkthimit.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Le të  
6 vazhdojmë, dhe pastaj të sigurohemi që dëshmitari të ketë  
7 mundësinë që të flasë me dikë nga Gjykata pa praninë e palëve  
8 apo të personave që janë këtu në Gjykatë.

9 E kuptuat, Dëshmitar?

10 DËSHMITARI: Me kënaqësi do ta bisedoja me ju në detale me  
11 cilindo prej Gjykatësve, por jo prapa shpine të flitet sikur  
12 unë jam i kushtëzuar apo kam faje që jam këtu. Për atë që jam  
13 këtu jam i ftumë nga ju.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në këtë pikë  
15 nuk është me vend që neve t'ju bëjmë pyetje më tej lidhur me  
16 këtë. Do të sigurohemi që dikush tjetër t'ju bëjë pyetje dhe  
17 pyetjet do bëhen në praninë tuaj. Kështu që do t'i lejojmë z.  
18 Emmerson që të vazhdojë me pyetjet për ju.

19 Z. EMMERSON: [Përkthim] Do shohim në qoftë se mund ta  
20 sqarojmë këtë.

21 PY. Megjithatë, për momentin do të vazhdojmë dhe t'i  
22 qëndrojmë fakteve të dëshmisë tuaj. Se pa diskutim që nuk  
23 është pa relevancë dëshmia juaj, kështu që pyetjet kanë si  
24 qëllim që t'ju marrim disa detaje apo informacione të tjera  
25 shtesë për sa i përket përvojës që keni.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04765 (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson (Vazhdim)

Faqe 70

1 Gjatë fazës së parë, fazës që përshkruat kur keni qenë  
2 komandant batalioni në Budakovë, besoj se i thatë Prokurorit  
3 në intervistën me ZPS-në që goxha shpejt ju bë e qartë juve, u  
4 bë e qartë për ju, që kishte probleme të përditshme të cilat  
5 duhej që të zgjidheshin nga një lloj oficeri i policisë  
6 ushtarake në Budakovë, a është e vërtet kjo, dëshmitar?  
7 PË. Cila është relevanca për klientin e juj, z. Avokat? Ju  
8 lutem, ato çka lidhen me klientin e juj, më folni ju. Lidhur  
9 me klientin tjetër, fol Avokati tjetër. Ato çka duhet me m'i  
10 thanë Gjykatësi, le të m'i thotë. Pse gjithë kjo, gjithë këto  
11 fishekzjarre?

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,  
13 vendimin se çfarë ka relevancë dhe çfarë nuk ka relevancë e  
14 marr unë. Detyra juaj është që t'i përgjigjeni pyetjeve që  
15 bëhen.

16 DËSHMITARI: Okej.

17 Z. EMMERSON: [Përkthim] Disa prej pyetjeve nuk janë  
18 specifike për klientët. Por kanë të bëjnë me dëshminë që i  
19 keni dhënë Prokurorisë dhe Trupit Gjykses sa i takon  
20 strukturave brenda zonës operative të Pashtrikut. Ju lutem, më  
21 duroni, nuk është se kam ndonjë prapaskenë, janë thjesht  
22 pyetje të përgjithshme që kanë të bëjnë me analizën dhe me  
23 përshkrimet e dhëna prej jush.

24 Do doja që të ktheheshim pas në periudhën e parë prej tre  
25 periudhave, kur keni qenë komandant batalioni në Budakovë.

1 Pyetja, mbështetur në dëshminë që i keni dhënë Prokurorit,  
2 është që besoj që i keni thënë Prokurorit që shpesh u has,  
3 shpejt u hasët me probleme të cilat kishin një lloj zgjidhjeje  
4 të policisë ushtarake në zonë e Budakovës, a është e vërtetë  
5 kjo, dëshmitar?

6 PË. Po, e din Prokurori është e vërtetë, ato çka i kam thanë  
7 nuk jam pishman. Dhe ato çka ti them ty i them edhe mbas  
8 dhjetë vjet, e njizet vjet, nuk i ndërroj.

9 PY. Nuk po kundërshtoj atë çfarë po thoni. Thjesht po ju  
10 kërkoj që të sqaroni gjëra të caktuara. Pra, po flasim për  
11 fazën e parë kur keni qenë në Budakovë. Atëherë, pa u shkuar  
12 tek pjesa, tek paragrafi, në qoftë se është e nevojshme  
13 gjithsesi mund të kërkojmë që të paraqitet në ekran, por që,  
14 që në fillim ju keni përshkruar që kishin vënë re se kishte  
15 çështje që duheshin të zgjidheshin lidhur me policinë ose  
16 civilët. Për shembull ju thoni dhe këtu citoj:

17 "Dikush godiste makinën e dikujt e tjetër dikush futej në  
18 një zënkë në një përleshje me dikënd tjetër, mbase mund të  
19 duket gjë qesharake, por ndonjëherë duhej që të ndërhyje edhe  
20 për të pajtuar burrin me gruan."

21 Këtë i keni thënë Prokurorisë. Ajo çfarë po ju pyes unë  
22 lidhur me këtë gjë, është që a është e vërtetë të thuhet që në  
23 nivel vendor ju keni caktuar një person që quhet Musa Koloni  
24 [Sipas përkthimit] për këtë rol, a është e vërtetë kjo, apo  
25 jo?

1 PË. Kololli.

2 PY. Kololli, kërkoj ndjesë. Ai --

3 PË. Dëgjo, se shumë bëne pyetje. Më lejo të përgjigjem.

4 Përndryshe fol ti unë veç them po, jo, po, jo, u kry.

5 Ju thatë se ka pasë arsye me u bo njësi intervenuese  
6 apo polici e UÇK-së për shkaqe të problemeve, qofshin ato  
7 civile apo ushtarake. Policia ushtarake ka qenë polici  
8 ushtarake, jo civile, edhe është bo për ushtarët, për  
9 problemet e ushtarëve. Jo për problemet e popullit se s'kemi  
10 mujtë na ta drejtojmë popullin.

11 Unë kam pasë në zonë teme 200.000 njerëz të strehumë  
12 nëpër tenda, e nëpër përroje, e kemi siguru mbulojat, i kemi  
13 siguru ushqimin, barnat, mjekun. Dhe i kena mbrojtë fizikisht  
14 me trupin tonë. Nuk mund t'i marrim përsipër krejt me një  
15 përgjigje, po, jo.

16 Musë Kololli ka qenë komandant i asaj njësie të policisë.

17 PY. Ai kishte qenë zëvendëskomandant i policisë në Prishtinë  
18 në regjimin e Jugosllavisë, apo jo?

19 PË. E vërtetë. Për atë që kishte përvojë, edhe me sugjerimin  
20 e fshatit, e kemi pranë.

21 PY. Sapo do thoja që ishte rekomandu nga fshati i Budakovës,  
22 nga kryepëllqetë e fshatit të Budakovës që ai ishte një person  
23 me karakter dhe që duhej emëruar në atë pozicion, dhe që vinte  
24 nga një familje e mirë, kështu?

25 PË. Ashtu është. Këshilli i fshatit, ashtu.



1 Z. EMMERSON: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares të  
2 paraqesë në ekran provën materiale P707, Pjesa 2.  
3 Ju kërkoj ndjesë, Pjesa 4. Atëherë, prova materiale P707.4.  
4 PY. Në rreshtin 16 dua që të lexoni, se çfarë keni thënë  
5 lidhur me rolin e policisë ushtarake në atë kohë.

6 Z. EMMERSON: [Përkthim] E thashë gabim prapë, atëherë  
7 është prova materiale P707.4, faqja 3, e intervistës së katërt  
8 të thënë nga dëshmitari.

9 DËSHMITARI: Nuk ndërroj asnjë shkronjë, z. Avokat. Ato  
10 çfarë i kam thanë te Prokurori janë kredibile. Asnjë shkronjë  
11 s'e ndërroj. Dhe s'ki pse humb kohën, të lutem.

12 PY. Nuk po ju kërkoj që të ndryshoni gjë.

13 PË. Ashtu merreni siç është, siç është.

14 PY. Në rreshtin 15, ju bën pyetje Prokurori --

15 Z. EMMERSON: [Përkthim] Do ju kërkoja që të shikonit  
16 rreshtin 15, dhe pastaj deri në fund të faqes. Në versionin në  
17 shqip është rreshti 21. Domethënë nga 15 deri në 21.

18 PY. Në rreshtin 22 ju thoni -- pyetja është:

19 "Cilat janë detyrat e policisë ushtarake?

20 Ju përgjigjeni.

21 "Si gjithmonë policia, si tash, por tash -- kishte më  
22 shumë punë se tani. Ne s'kemi pasë polici civilë, se ata kanë  
23 qenë krejt të serbit. Ata kanë luajtur role mes ushtarëve dhe  
24 civilëve. Kryesisht janë marrë me ushtarë. Kështu që, në goftë  
25 se, për shembull, ushtarët kishin problem me civilët, për

1 shembull, është vjedhë një kerr, është thy diçka, ose ka pasë  
2 ngatërresë me gjëra, si këto janë marrë.

3 Pyetja tjetër është kjo:

4 "Edhe policia ushtarake, a do të kryente ndonjë arrestim  
5 nëse do të ishte e nevojshme, për shembull?

6 Në përgjigje ju thoni:

7 "Jo në kuptimin klasik, ndoshta jo, por do ta vinin  
8 ushtarin në komandë, do ta çarmatosnin, nëse ka bërë ndonjë  
9 veprim. Në qoftë se është thyer disiplina, ose në qoftë se ka  
10 pi dhe ka nxjerrë telashe. Shumë herë, për shembull,  
11 popullatën kur kemi pasë me e strehu në male, nëpër gryka,  
12 kanë ardhur e janë ankuar se kanë vjedhë nëpër shitore, ka  
13 keqpërdorim të vajzave. Disa raste kam çuar katër policë, disa  
14 raste gjashtë, tetë policë, varësisht prej problemeve."

15 Pyetja ime për ju është kjo: Ky përshkrim a është i  
16 vërtetë për periudhën kur keni qenë komandant batalioni në  
17 Budakovë apo i përkon periudhës pas emërimit tuaj në janar si  
18 shef i policisë ushtarake, të cilën e diskutuam, pra, kur u  
19 caktua Nazmi Krasniqi [Sipas përkthimit] si shef i policisë  
20 ushtarake? Pra, ishte rast i përgjithshëm, domethënë, ky  
21 përshkrimi që ju dhatë ishte i përgjithshëm, zbatohet në  
22 mënyrë të përgjithshme apo ishte i vërtetë në një periudhë  
23 specifike, konkrete, dëshmitar?

24 PË. Spjegimi është i përgjithshëm, edhe pyetjet po mvaren si  
25 po më bëhen. Kur bëhet pyetja e përveçme, çfarë ka qenë në

1 Budakovë, flasim për Budakovë, kur thojmë çka kanë pasë rol  
2 policia, çfarë detyrash kanë pasë, flasim për të përgjithshme.  
3 Unë nuk heqi asnjë presje.

4 PY. Po, e kuptoj që po flasim për Budakovën. Por, a jepet  
5 këtu edhe një shpjegim i saktë i operacioneve ose punës së  
6 policisë ushtarake pas janarit dhe emërimit siç na thatë ju në  
7 të Nexhmi Krasniqit si shefi i policisë ushtarake të zonës?

8 PË. Unë thashë në fund të marsit, fillim të prillit, jo z.  
9 Emmerson. Po harroni ju vetë apo doni që ashtu me harru?

10 PY. Nuk po harroj. Ndoshta ka ndonjë problem në komunikim.  
11 Por pyetja ime është mjaft e thjeshtë. Shpjegimi që i dhatë  
12 ZPS-së për rolin e policisë ushtarake, a i aplikohet edhe 1999  
13 kur policia ushtarake në zonën e Pashtrikut ishte nën komandën  
14 e Nexhmi Krasniqit? A ishte njësoj atëherë siç ishte dhe në  
15 fillim?

16 PË. Po, po. Po.

17 PY. Faleminderit.

18 PË. Këtu ke të drejtë.

19 PY. Ka po -- kjo ishte pyetja ime.

20 Z. EMMERSON: [Përkthim] Dhe në atë kontekst, dëshiroj të  
21 kalojmë për të parë P509, ju lutem.

22 PY. Këtu kemi një gjë që unë do ta quaja organigramë, një  
23 strukturë që është riprodhuar prej jush, në librin tuaj, ku  
24 shpjegoni rolet e ndryshme të personave të ndryshëm në zonën e  
25 Pashtrikut.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04765 (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson (Vazhdim)

Faqe 76

1 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ju lutem, prisni pak sa ta  
2 shfaqim në ekran.

3 DËSHMITARI: Veç juve mos t'ju bëhet vonë. Unë pres sa të  
4 doni.

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] A e kemi numrin?

6 Z. EMMERSON: [Përkthim] Duhet të jetë P509. Por ERN-ja  
7 është SPOE00209330. I është dhënë numër prove materiale. Dhe  
8 faqet janë nga 209321 deri në 209428-ET. Z. Pace ia ka treguar  
9 këto faqe dëshmitarit.

10 Z. PACE: [Përkthim] Mendoj se tashmë quhet P712, nëse e  
11 ndihmon Gjykatën kjo gjë.

12 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ah, qenka numër tjetër.

13 DËSHMITARI: Po, shifet.

14 Z. EMMERSON: [Përkthim]

15 PY. A e njihni këtë faqe nga libri juaj, i cili në fakt është  
16 bazuar te doktoratura juaj, apo jo?

17 PË. Si s'e njoh librin tim? Po.

18 PY. Po, në rregull. Faleminderit.

19 Z. EMMERSON: [Përkthim] Atëherë, ju lutem, nëse është e  
20 mundur -- përkthimin e kemi këtu përbri dhe nëse mund ta  
21 zvogëlojmë pak përkthimin në anglisht. Po, fiks, faleminderit.

22 PY. Pra, mendoj që mund ta shikojmë nga pozicioni juaj në mes  
23 si zëvendëskomandant i zonës të Pashtrikut që këtu bëhet fjalë  
24 për periudhën e tretë kohore, fazën e tretë që ju keni  
25 shpjeguar, nga fundi i marsit deri në qershor?

1 PË. Po.

2 PY. Por, po të shikojmë komandantin e zonës në atë moment,  
3 është Tahir Sinani, i cili ka ardhur pas Drinit, apo jo?

4 PË. Po, ashtu është.

5 PY. Pra, Drini ka qenë komandant i zonës nga janari, na thatë  
6 ju më duket, e kam të saktë që ka qenë 17 mars kur ai u  
7 zëvendësua nga Tahir Sinani?

8 PË. Realisht më 17 mars është caktu Tahir Sinani edhe unë si  
9 zëvendëskomandant.

10 PY. Pra, kjo është struktura në fazën përfundimtare, dhe këtu  
11 mund të shohim poshtë në fakt Nexhmi Krasniqin si komandant i  
12 policisë ushtarake?

13 PË. Po.

14 PY. Dhe më poshtë, poshtë departamenteve te zona operative  
15 mund të shikojmë Nexhmi Kastratin, te G3, dhe Halil Qadrakun  
16 si departamenti i zbulim-kundërzbulimit te G2. Gjithashtu, në  
17 nivel tuaj në të djathtë mund të shikojmë Nazir Kryeziu, si  
18 udhëheqësin e njësisë speciale Syri i Shqiponjës.

19 Tani më lejoni që t'ju bëj disa pyetje në bazë të kësaj  
20 që pamë. Kjo është struktura, ose organigrama juaj kur i  
21 hidhni sytë pas në të shkuarën, por jo ndoshta situata e cila  
22 njihej në kuptim të raportimit në atë kohë, pra është një  
23 analizë e mëtejshme nga ana juaj, e mëpasshme?

24 PË. Keni shumë të drejtë, por diçka të tillë kemi imagjinu  
25 dhe kemi pasë në dorë të shkruar nëpër fletore me laps, me

1 kimik. Ndërsa kjo u punu ma vonë. Është çështje e krahasimit  
2 të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me ushtritë të tjera guerile  
3 të botës. Që është e veçantë dhe është specifike. Prandaj  
4 është speciku ky organogram se çfarë ka vyjtë me qenë.

5 PY. Po, saktë. Ashtu duhet të jetë, e kuptoj. Por kjo është  
6 analiza juaj, nuk është diçka që u shkrujt në atë kohë, apo  
7 jo?

8 PË. Edhe nëse nuk ka pasë një organogramë të qartë në atë  
9 kohë, punët janë ba të tilla dhe është mendue në mënyrën e  
10 tillë.

11 PY. Kur ju ka marrë në pyetje Prokuroria -- ose a mund të  
12 lexoj dy fragmente dhe t'ju kërkoj që të bëni koment në lidhje  
13 me to? E kam fjalën, pra, për strukturën. Ju keni thënë këtë:

14 "... në rast se këta persona kur u jepet kjo strukturë,  
15 ata thonë 'po, unë këtë nuk e dija', sepse nuk e kanë parë për  
16 shembull të vendosur në ndonjë mur të afishuar. Dhe nuk kanë  
17 patur zyra të tilla që të ketë qenë statike. Sepse UÇK-ja ka  
18 qenë një strukturë në lëvizje, mobile, edhe shumica prej tyre  
19 po t'i pyes se çfarë pozicioni keni patur, ata do thoshin 'unë  
20 nuk e dija këtë, thjesht dija çfarë bëhej, por përndryshe mos  
21 të mos dija nivelet e strukturës'.

22 Dhe kjo është një nga këto gjërat që keni thënë ju, dhe  
23 kishte të bënte me këtë organigramë, me këtë strukturë apo jo?

24 PË. Asht kam thanë, ashtu tham prapë. Nuk e lëvizim asnjë  
25 presje, asnji pikë.

1 PY. Po, na ndihmon. Dhe pak më vonë, ju thatë që shumica prej  
2 tyre --

3 Z. EMMERSON: [Përkthim] Edhe këtu thjesht për Gjykatën,  
4 është Pjesa 1, faqja 16, rreshti 21, dhe pastaj -- më falni,  
5 gjatë gjithë kohës ju kam dhënë referencën e mëparshme, pra në  
6 fakt bëhet fakt për Pjesën 1, faqja 16, rreshti 21. Dhe pyetja  
7 që ju bëhej ishte kjo:

8 "A e konsideroni strukturën të saktë sipas këtij libri?

9 Dhe ju thatë:

10 "Nëse jo, atëherë doktoratura ime do të hidhet në kosh të  
11 plehrave."

12 Dhe ju vijuat duke thënë:

13 "Shumica prej tyre nuk i dinin rolet që kishin në këtë  
14 strukturë, dhe çfarë detyrash u ishin dhënë. Dhe kështu siç  
15 shkruhet edhe këtu, drejtoria politike dhe personat në atë  
16 drejtori ose rolet që ata kishin, është shumë e mundur që ata  
17 të mos t'i dinin se cilat ishin këto role apo dhe zinxhirin  
18 hierarkik. Pra kush raportonte te kush.

19 Pra ky ishte shpjegimi juaj kur shikonit këtë  
20 organigramë, strukturë, në intervistën tuaj me ZPS-në dhe  
21 besoj që ky është një shpjegim i saktë, edhe për juve, me të  
22 cilin bini dakord, apo jo?

23 PË. Në përgjithësi, në përgjithësi, jam dakord, por aty ku  
24 thoni doktoratura, s'është, është magjistratura,  
25 magjistratura. Dhe është e vërtetë se një departament nuk i ka

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04765 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 80

Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson (Vazhdim)

1 njoftë detyrat e një departamenti tjetër. Një drejtori s'i ka  
2 njoftë detyrat e drejtorisë tjetër, një komandant brigade nuk  
3 i ka ditë punët e brigadës tjetër, se s'ka qenë ajo lidhja  
4 fizike e mundshme. Dhe në këtë kuptim kam thanë që njëni-  
5 tjetrit s'mund ia kishin bo vendin dhe s'mund t'i kishin  
6 numëru detyrat çfarë është kanë dashtë me bo.

7 PY. Por si zëvendëskomandant i zonës që nga gjysma e dytë e  
8 marsit deri në qershor, ju ishit në një pozicion të tillë që i  
9 dinit më mirë se të tjerët se cilat ishin caktimet, detyrat e  
10 caktuara, cilat duhet të kishin qenë ato, apo ishin, apo jo?

11 PË. Po, dakord.

12 PY. Kështu që, nga ajo pikë e tutje të paktën, mund ta  
13 përdorim këtë shënim, këtë faqe, për t'ju bërë këtë pyetje.  
14 Kemi tre periudha, në 1999. Janar deri në gjysmën e dytë të  
15 marsit kur ishte Drini komandant në krye, më pas periudha nga  
16 17 marsi e tutje kur Tahir Sinani ishte i përfshirë, dhe ju u  
17 emëruat, mendoj në të njëjtën kohë si zëvendëskomandant i  
18 zonës, apo jo? Pak a shumë në të njëjtën kohë, apo jo?

19 PË. Ashtu, ashtu është.

20 PY. Tani, Nexhmi Krasniqi ishte në detyrë tashmë, si  
21 komandant policie, kur ju në gjysmën e dytë të marsit u  
22 caktuat si zëvendëskomandant i zonës. Ai vijoi në punën e tij,  
23 nga periudha e mëparshme, apo jo? Është e saktë kjo?

24 PË. Nuk e di a ka qenë në të njëjtën kohë, nuk e di a kemi  
25 qenë të njëjtën kohë të emërumë, por kooperimi ka qenë i



1 përbashkët, ai ka qenë komandant i --

2 PY. Po.

3 PË. -- kompanisë, policisë ushtarake në nivel të zonës.

4 PY. Ashtu siç tregon dhe diagrama juaj, nga data 17 mars e  
5 tutje ka qenë në atë detyrë. Kush e emëroi atë në atë rol?

6 Drini apo Tahir Sinani?

7 PË. Për ta emëruar, ndoshta u bo ma herët, se ka bo kërkesë  
8 Drini. Por të marrë vendim, sigurisht e kanë marrë në këtë  
9 kohë vendimin, por Tahir Sinani ka qenë komandanti i gjithë  
10 zonës, që atij iu dashtë me raportu Nexhmedini dhe me i rujtë  
11 raportet mes komandantit të zonës dhe kompanisë së policisë  
12 siç e kanë pasun togjet në mes togut të policisë me  
13 komandantin e brigadës. Domethënë, ka shku një vijë.

14 PY. Në rregull. Dhe ju tashmë na e keni dhënë shpjegimin e  
15 përgjithshëm të funksioneve. Ashtu siç e keni shpjeguar, pra,  
16 edhe ju të policisë në atë kohë.

17 G2, që ishte zbulimi dhe kundërzbulimi, Halil Qadraku,  
18 besoj që jemi të sigurt që ai u emërua nga Drini dhe për atë  
19 arsye qëndroi në atë pozicion edhe kur mori kryesinë Tahir  
20 Sinani. Se ju thatë që ai erdhi me Drinin.

21 PË. E vërtetë është. E vërtetë.

22 PY. Dhe, në fund, te G3, Nexhmedin Kastrati. A mund t'ju bëj  
23 pak pyetje në lidhje me të? A ka patur ndonjë mënyrë tjetër  
24 për të shpjeguar funksionin e tij, pozicionin e tij brenda  
25 zonës së Pashtrikut përveçse G3 ops? A ka patur ndonjë fjalë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04765 (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson (Vazhdim)

Faqe 82

1 tjetër që është përdorur më zakonisht?

2 PË. Nuk ka pasë funksion tjetër, përkundra edhe këtu nuk ka  
3 qenë ma gjatë se një muaj, sepse këta oficerët që kanë luftu  
4 në Bosnje në ish-luftërat jugosllave, kanë ardhë me vonesë  
5 shumë, dhe nuk ka qenë i rregullt. Fillimisht është caktue  
6 komandant brigade në janar, deri në shkurt, fund shkurti.  
7 Pastaj ka ndejtë një muaj -- ka ndejtë... Ky kry funksionin  
8 një muaj në G3, që është operativa. Dhe më 1 prill prapë ka  
9 shku në operacionin Shigjeta. S'ka pasë mundësi tjetër çka me  
10 i thanë këtijna. Me i thanë satelit, që fluturon në atë anë,  
11 në këtë anë.

12 Çfarë po kërkoni, ju lutem? Konkretizojeni pyetjen, mos  
13 t'ju vijë keq, mos t'ju vijë keq për pyetjen.

14 PY. Po, në fakt thjesht po bëj pyetje për rolet dhe  
15 funksionet. A do të pranoni ju që shpjegimi i tij në zonën e  
16 Pashtrikut do ishte si kryetar -- shef shtabi? Për shembull,  
17 në rast se Nexhmedin Kastrati do të thoshte që ai ishte shef i  
18 shtabit, ju si do t'i përgjigjeshit kësaj?

19 PË. Veç të më thotë që e ka ushtru një ditë, ose ka marrë një  
20 copë letër nga dikush që është shef shtabi. S'ka pasë zona  
21 operative e Pashtrikut, s'ka pasë shef shtabi. Por ata tu  
22 dashtë gjithmonë me e ngritë veten, edhe në këtë kuptim kanë  
23 ra ndesh me interesat e atyne për ta marrë komplet UÇK-në nën  
24 udhëheqjen e oficerëve të Bosnjës, oficerëve të JNA-së, të  
25 ushtrisë jugosllave. Dhe ndoshta ka ndejtë i pakënaqun, në

1   apetitët e tij ka andërru me qenë ai ndoshta aty. Nuk ka  
2   ekzistuar, s'mund të kthejmë mbrapë historinë.

3   PY.   Jo, dhe ju thoni që ai arriti më vonë dhe u largua më  
4   herët, me pak fjalë nga zona.

5   PË.   Ashtu është.

6   PY.   A mund të na e jepni vlerësimin tuaj për të si person në  
7   atë rol?

8   PË.   As në atë rol s'është kanë i rregullt, as në role të  
9   mavonshme pas luftës. Nuk kam mendime të mira.

10  PY.   Nuk keni mendime të larta për të. Mund t'ju pyes pse?

11  PË.   Po nuk isha, tash nuk kisha me u prononcuar këtu, derisa  
12  nuk ka kry ndonjë rol të rëndësishëm në luftën e UÇK-së. Dhe  
13  pas luftës ata të cilët kanë qenur në luftimet në Bosnjë kanë  
14  dalë profiterë të luftës.

15  PY.   Në rregull, nuk do t'ju bëj ndonjë pyetje për të cilën  
16  ndoshta ju nuk dëshironi të përgjigjeni, por a ka ndonjë gjë,  
17  fakt, ndonjë ngjarje mbi të cilat ju bazoni mendimin tuaj për  
18  të, opinionin tuaj për të? Diçka që do të ishte relevante për  
19  vlerësimin për të?

20  PË.   Po të kisha, po të kisha ndonjë fakt, do ta thoja. Janë  
21  ato opinione, janë që është folë, për atë nuk duhet të them  
22  asgjë. Faktet mundet me i gjetë Prokuroria, jo unë.

23  PY.   Në rregull. Atëherë, vetëm një ose dy pyetje të tjera kam  
24  në lidhje me këtë çështje. Nuredin Abazi ka qenë jurist, siç  
25  sugjerohet nga roli i tij, apo jo? Është e saktë kjo? dhe --

1 PË. Po. E ka pasë fakultetin juridik dhe ka qenë këshilltar  
2 në zonën operative të Pashtrikut.

3 PY. Atëherë, thjesht për të na ndihmuar ne me të gjitha  
4 pjesët e ndryshme, dhe të shigjetave. Ai, domethënë, shigjetat  
5 e forta do të thotë që janë emëruar nga Tahir Sinani, apo jo?

6 PË. Domosdoshmëria e lidhjeve dhe raporteve është e shënuar  
7 me shigjetë të plotë. Ndërsa në rastet e jashtëzakonshme kur  
8 s'ka mundë ta takojë Tahirin, ka mundë të komunikojë dhe me  
9 mu, ose me dikë tjetër, mes veti, mes G-ve, mes --

10 PY. E kuptova. Domethënë vija me pika-pika, atëherë, në qoftë  
11 se vija e raportimit normale nuk ishte e disponueshme atëherë  
12 mund të raportonte diku tjetër, pra, ndonjëherë mund të  
13 konsultoheshit me Nuredin Abazin, por zakonisht raportimi i  
14 tij i zakonshëm ka qenë me Tahir Sinanin, është e saktë kjo?

15 PË. Ashtu është, e saktë.

16 PY. Atëherë, a e dini se kush e emëroi atë në atë rol?

17 PË. Unë mendoj se Tahir Sinani e ka emëru. Megjithëse ka  
18 luftë një rol të tillë, edhe në nivel të batalionit të  
19 Budakovës. S'kemi pasë juristë, s'kemi pasë juristë.

20 PY. Ju e keni njohur që në Budakovë?

21 PË. Po.

22 PY. Dhe, gjithashtu, Nezir Kryeziu, në atë njësinë e --  
23 ndonjëherë raportonte edhe -- pavarësisht se normalisht  
24 raportonte te Tahir Sinani, ndonjëherë raportonte dhe te ju,  
25 është e saktë kjo?

1 PË. E saktë është, unë nuk dua t'i mbarti Tahir Sinani,  
2 pasiqë ai është dëshmor, është një hero, dhe t'u iki  
3 përgjegjësive. Por duhet ta ndihmoj këtë proces të vazhdojë sa  
4 ma shpejt dinamika e kësaj Gjykate. Ashtu është, që ai është  
5 emëruar komandant i njësisë Syri i Shqiponjës nga Tahiri, por  
6 plani për këtë njësi është ba i përbashkët, është ba i  
7 përbashkët sepse ka pasë disa ushtarë mes njësisish, që nuk kanë  
8 pasë këtë sistemim, dhe kanë qenë me përvojë shumë të mirë  
9 luftarake. Por ka pasë prej tyre që kanë dezertu një kohë,  
10 janë rikthyer, kanë qenë të padurushëm në njësitë e mëparshme,  
11 dhe u kriju një njësi e veçantë intervenuse ma lehtë, ma  
12 shpejt, Syri i Shqiponjës. Neziri ka qenë komandant i kësaj  
13 njësie. Duket i qartë jam. Nëse i ke mbajtur mend të gjitha,  
14 kërkoj falje.

15 PY. Jo, jo. Na ndihmuat goxha. Pra, u krijua aty në atë zonë,  
16 brenda për brenda Pashtrikut, nga Tahir Sinani, por ishte si  
17 grupet e tjera, ose forca speciale të themi që hynin me  
18 reagimin e shpejtë, që përgjigjeshin shpejt?

19 PË. E saktë.

20 PY. Faleminderit. A dini se kur është krijuar me përfaqësi,  
21 kur është krijuar, besoj që ka qenë pas mesit të marsit, besoj  
22 unë, por ju dini gjë se kur është krijuar si fillim?

23 PË. Unë mendoj që duhet të jetë 2 prill -- kah mesi i  
24 prillit, më 2 maj e mbaj mend njëfarë aksioni kanë bo. Kah  
25 mesi i prillit është kriju kjo. Mesi i prillit.

1 PY. Faleminderit shumë. Po, më është kërkuar që të sqarojmë  
2 që a e keni fjalën për prillin 1999, apo jo?

3 PË. 1999, 1999. Më fal.

4 PY. Jo, jo, jo. Është faji im në fakt. Besoj që kam të drejtë  
5 të them që gjatë kohës suaj me përgjegjësinë që kishit për  
6 moralin, ajo periudhë pra nga janari dhe deri në, nga fundi i  
7 marsit, ju në një moment keni qenë i pozicionuar brenda  
8 Shtabit të Përgjithshëm, është e saktë kjo?

9 PË. Po, kam qëndruar, gati q'ashtu një muaj, nuk e di a ma  
10 shumë a ma pak. Një muaj po. Një muaj.

11 PY. Dhe ju e kuptuat se kush hynte e kush dilte nga Shtabi i  
12 Përgjithshëm në atë kohë, apo jo?

13 PË. Nuk kam qenë krejtësisht i rregullt, sepse në atë kohë ka  
14 qenë masakra e Reçakut, dhe unë jam detyrue me shkue në luftë  
15 për shpëtimin e popullatës të Reçakut. Dhe kemi luftuar katër  
16 ditë e gjysmë për t'i mbrojtur edhe kufomat në Reçak, sepse  
17 donin t'i merrnin forcat policore, serbe, për t'i hupë gjurmët  
18 e arsyes së vdekjes së tyre. Nuk kam qenë krejt kohën, kam  
19 qenë pak në dhjetor, në fund të dhjetorit. Kam qenë deri në 15  
20 janar, më 15 janar është bë masakra e Reçakut dhe pas masakrës  
21 së Reçakut nuk kam shku atje për të qëndruar. Kështu është  
22 realiteti.

23 PY. Atëherë, ju i keni thënë Prokurorisë që ju dini nga  
24 kontaktet tuaja me Shtabin e Përgjithshëm që Kadri Veseli nuk  
25 ka qenë në Kosovë ndërmjet fillimit të janarit dhe më pas

1 gjatë kohës së atij viti, është e saktë kjo?

2 PË. E saktë, ashtu e kam thanë, dhe ashtu mendoj edhe tani.

3 PY. Do t'i kthehemi kësaj çështjeje pak më vonë. Por unë  
4 mendoj që ju keni qenë i pranishëm kur ju mendoni që ai u  
5 kthye në Kosovë nga Shqipëria, dhe ju shpenzuar pak kohë në  
6 një automjet me të, në një makinë me të, duke diskutuar luftën  
7 në përgjithësi, është e saktë kjo?

8 PË. Po, ka pasë një rast kur ai u kthi prej Rambujeje, a prej  
9 Shqipërie, nuk e di kah ka ardhë. Nuk e di nga ka ardhë, se  
10 s'e kam pyetë, por ka ardhë në zonë, në Nishor dhe gjatë  
11 bisedës e shprehu qëllimin për të shkuar ma lart në fshatrat  
12 ma të thella dhe unë e kam marrë me makinë teme, e kam  
13 përcjellë që do e baja për çdo qytetar, për çdo ushtar tjetër,  
14 njësoj.

15 Unë tek atëherë e kam njoftë me emën Kadri Veselin, deri  
16 atëherë e kam njoftë vetëm si Luli.

17 PY. Po. Thjesht që të jemi të qartë, ai nuk ka qenë i vetmi  
18 person që e përdorte emrin Luli, apo jo? Se ka patur edhe  
19 komandantë të tjerë me emrin Lulin, apo jo?

20 PË. Ka pasë me dhjetëra, me dhjetëra Luli e Cungo, e Bungu, e  
21 Guri, shumë ka pasë, shumë ka pasë. Jo një herë, por ma shumë.

22 PY. Por që t'i kthehemi asaj çështjeje, ju identifikuat  
23 faktin që në atë udhëtim kur ai po kthehej pas Rambujesë, në  
24 intervistat tuaja me Prokurorinë, ju keni thënë që kjo ka  
25 ndodhur në fillim të prillit, është e saktë kjo apo ishte

1 hamendësim? E mbani mend me përfaqësi kur ka ndodhur kjo apo  
2 jo? Ky takim?

3 PË. Nuk jam i sigurt dhe nuk jam se, ndoshta në fillim të  
4 prillit akoma kanë qenë në Rambuje, por duhet të jetë kah mesi  
5 i prillit dikund. Çështje kohe, nuk jam shumë i sigurt. Veç  
6 rasti është shumë i saktë. Me makinë teme dhe një shofer kemi  
7 pasë, kemi udhëtue.

8 Z. EMMERSON: [Përkthim] Atëherë, a mund të vendosim në  
9 ekran SPOE00054541. Po, pikërisht. Duhet të kemi dhe  
10 origjinalin në gjuhën shqipe. Apo nuk e kemi?

11 Nuk e di, a e kemi këtë të njëjtën gjë në gjuhën shqipe,  
12 ju lutem, në sistem? [REDAKTUAR]...

13 DËSHMITARI: Kuptohet, edhe kështu kuptohet. Urdhëroni me  
14 pyetjen.

15 Z. EMMERSON: [Përkthim]

16 PY. Atëherë, në përgjithësi, ju na thatë që pas Rambujesë,  
17 pati një riorganizim të konsiderueshëm. Dhe në atë kohë ju  
18 shpjeguat dhe thatë që u bëtë zëvendëskomandant i zonës, Tahir  
19 Sinani u bë shefi i zonës së Pashtrikut, e të tjerët, e gjithë  
20 ajo struktura që kemi parë. Por besoj që është e saktë kur  
21 them, dhe ju e dini që në atë fazë duke i paraprirë të ardhmes  
22 pati një riorganizim edhe në nivel shtabi, apo jo?

23 PË. Unë mendoj se pas Rambujesë organizimi ka shku në  
24 drejtimin e qeverisë së përkohshme, jo në rikonsolidimin e  
25 shtabit. Kam dhanë edhe vërejtje, edhe ajo ndodhet edhe te



Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04765 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 89

Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson (Vazhdim)

1 Prokurori, që shumë pak janë marrë me çështjen e luftës. Ajo  
2 ka mbetë krejt në shpinën tonë, zonat e kanë bo luftën.  
3 Komandantët e brigadave.

4 Ndërsa njerëzit që ishin në Rambuje, që na i kena  
5 përkrahë, për qëndrimin, për vendimet që janë marrë atje, se  
6 s'ka pasë zgjidhje tjetër, bile kemi pasë zona jonë një  
7 kundërshti ndaj atyne tendencave për të ndryshu komanda.  
8 Derisa këta kanë qenë jashtë, është bërë një puç ushtarak  
9 mbrenda në Kosovë. Zona operative e Pashtrikut edhe tri zona  
10 të tjera, domethënë katër zona, janë kanë për të vazhdue ajo  
11 që ka qenë udhëheqja, ndërsa tri zona kanë pranë ndryshimin.  
12 Dhe unë jam kanë shumë i pakënaqun këtë rast kur këta kthehen  
13 prej atje dhe nuk merren shumë ma me luftën, as me ne, as me  
14 planet, as me strategjinë, por kthehen dhe i krijojnë  
15 strukturat e Qeverisë së Përkohshme. Këtu pashë disa emra.  
16 PY. Po a do të ishte e drejtë të thuhej që rolet u  
17 zëvendësuan brenda Shtabit të Përgjithshëm, për shembull  
18 Bislime Zyrapi u zëvendësua nga Agim Çeku në atë moment, apo  
19 jo? Është e saktë kjo? Brendapërbrenda Shtabit të  
20 Përgjithshëm?

21 PË. Shyqyr që u bo ashtu. Shyqyr që u bo ashtu. Është e  
22 saktë, është zëvendësuar më 17 prill. Agim Çeku është emëruar  
23 shef i shtabit të UÇK-së.

24 PY. Dhe ka ndodhur një sërë ndryshimesh brendapërbrenda  
25 Shtabit të Përgjithshëm, pra persona që kanë zëvendësuar ata

1 që u bënë pjesë e institucioneve të Kosovës e të qeverisë së  
2 Kosovës?

3 PË. Po, është e vërtetë --

4 PY. Qeverisë së përkohshme të Kosovës --

5 PË. -- Bislimi në atë kohë ka qenë në operacionin Shigjeta,  
6 Agim Çeku u bë shef i shtabit, ndërsa Sylejman Selimi ma vonë  
7 u caktu komandant i gardës. Ka pasë ndryshime, ka pasë  
8 lëvizje. Keni të drejtë.

9 PY. Bislim Zyrapi, për shembull, u largua nga Shtabi i  
10 Përgjithshëm dhe u bë zëvendës ministër i mbrojtjes, në  
11 Qeverinë e re Përkohshme të Kosovës, kështu?

12 PË. Nuk jam i sigurt për Bislimin. E di që Fatmiri është bo  
13 zëvendës ministër i mbrojtjes, jo Bislimi. Bislimi u kthy për  
14 me organizu Shigjetën.

15 PY. Po, e drejtë. Azem Syla, që në librin tuaj përshkruhet si  
16 komandant i përgjithshëm, tani ndryshoi rolin dhe u bë  
17 ministër i mbrojtjes --

18 PË. Po.

19 PY. -- në formacionin e ri të qeverisë së përkohshme të  
20 veçantë nga Shtabi i Përgjithshëm apo jo? Do kërkoja që të  
21 shikonim numër 6, që kemi "Ministrin e shërbimit inteligjent  
22 të Kosovës", që kemi emrin e z. Veseli. Në këtë moment kemi  
23 ndryshimin e emërtimit nga ZKZ në SHIK, domethënë SHIK-u  
24 formalisht ekzistoi rreth kësaj periudhe, këtë keni dashur të  
25 thoni me atë çfarë përshkruani në librin tuaj?

1 PË. Jo, nuk di unë kur është formuar SHIK-u derisa ka qenë,  
2 deri më 12 qershor jam 200 për qind i bindun se vetëm ZKZ-ja  
3 ka qenë, masandej nuk di.

4 PY. Në rregull. Shumë mirë. Të shohim pak disa çështje të  
5 cilat duhet të sqarohen në kuadrin e përgjithshëm si në  
6 kontekstin e librit tuaj, por gjithashtu rreth dëshmisë që  
7 keni dhënë. E kemi prekur këtë edhe ca ditët më përpara. Keni  
8 thënë tashmë që disa prej dokumenteve të asaj kohe të cilat i  
9 referohen ose përmendin gjykatën e shkallës së dytë, nuk ka  
10 ndodhur asnjëherë një gjë e tillë sepse kjo ishte thjesht si  
11 plan, pra që do ekzistonte ose do të krijohet një gjykatë e  
12 nivelit të dytë, por në fakt atëherë nuk ka pasur një të tillë  
13 --

14 PË. Nuk ka pasë.

15 PY. A është e vërtetë kjo dëshmitar?

16 PË. Nuk ka pasë, as gjykatë të dytë, as të parë. E  
17 dëshirushme ka qenë, u kërku që të bëhen, të ofrohen juristë,  
18 të bëhen njerëz profesionalë, të bëhen lokale, të vazhdohet.  
19 Po të kishte zgjatë lufta dhe dy vjet, tri, jam i bindun se  
20 ato kishin ndodhun, ndoshta dhe ma shpejt. Por nuk i kemi  
21 pasë, nuk i kemi pasë.

22 PY. Kur ka pasur ndryshim udhëheqësie të udhëheqësve në zonën  
23 e Pashtrikut dhe kur z. Sinani u bë komandant i përgjithshëm i  
24 zonës së Pashtrikut dhe Drini u ricaktua në akademinë  
25 ushtarake, kam përshtypjen që kështu thatë, që të krijonte një

1 akademi ushtarake për trajnimet ushtarake. Është e vërtetë  
2 kjo?

3 PË. Ashtu ka qenë plani të krijohet një akademi ushtarake në  
4 nivel qendror, dhe Drini është caktuar drejtori i asaj  
5 akademi, apo komandant i asaj akademie.

6 PY. Por në fakt nuk ka pasë akademi atëherë, thjesht ishte  
7 plan që ju bënit për të ardhmen, por akademia nuk ekzistonte  
8 atëherë, kështu?

9 PË. Derisa, derisa ne kemi bë disa ushtrime edhe ma herët e  
10 kemi folë në seancën tjetër, është mendue që të bëhet një  
11 akademi për ushtrimin e ushtarëve, të oficerëve. Është mendu,  
12 s'ka pasë deri atëherë.

13 PY. Pra, ishte plan që të bëhej kjo, dhe Drini u caktua në  
14 këtë rol me datë 17 mars, ose rreth datës 17 mars. Edhe lufta  
15 përfundoi për tre muaj, ose më pak se tre muaj në atë kohë,  
16 kështu?

17 PË. Po ashtu, shumë gjana na kanë mbetë në tentativë, për t'i  
18 bë, si plan, si projekt, si qëllim, por nuk janë realizu. Nuk  
19 janë finalizu të gjitha. Ashtu është.

20 PY. Domethënë, përpara fundit të luftës, që mendoj që  
21 pajtoheni me mua, që fundi i luftës erdhi shumë herë më herët  
22 se sa pretendohet ose se sa mund të kishte menduar çdo person  
23 brenda UÇK-së, besoj se pajtoheni me mua lidhur me këtë?

24 PË. Juve ju duket herët, por neve na u ka dukë shumë, shumë  
25 gjatë. Se nuk është lehtë të jetosh një vit e gjysmë, dy vite,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04765 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 93

Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson (Vazhdim)

1 nëpër kanale, nëpër borë, nëpër shi. Për neve ka qenë shumë,  
2 shumë gjatë. Por megjithatë faktori ndërkombëtar, aleatët,  
3 kanë reagu ma shpejt se sa në Bosnjë. Edhe mirë që kanë bo  
4 ashtu.

5 PY. Në të njëjtin dokument, jo këtë dokumentin që kemi tani,  
6 por dokumenti që u paraqit më përpara që ishte pjesë e librit  
7 tuaj, do i kërkoja Sekretares që të paraqesë librin në faqen  
8 019321 [Sipas përkthimit].

9 Z. EMMERSON: [Përkthim] Mendoj që është faqja tjetër ose  
10 një faqe më përpara në provën materiale të pranuar. Faqja më  
11 përpara.

12 DËSHMITARI: Mund ta bëni pyetjen, z. Avokat. Unë jam i  
13 qartë me librin tem.

14 Z. EMMERSON: [Përkthim]

15 PY. Po, jeni i qartë me librin tuaj. Mirë atëherë, një prej  
16 diagrameve që do të paraqesë Sekretarja është analizë e  
17 ngjashme e roleve ose organigramë e ngjashme e përpiluar prej  
18 jush sa i takon roleve në Shtabin e Përgjithshëm. Megjithatë,  
19 unë mendoj që kjo i përket të njëjtës periudhe të, domethënë,  
20 periudhës së Tahir Sinanit, a është e saktë kjo dëshmitar?

21 PË. Po, po, në atë kohë është mendu ashtu, të jetë  
22 organogrami dhe njerëzit në funksione në Shtabin e  
23 Përgjithshëm, por ne ma shumë na ka udhëheqë, unë po flas për  
24 vete, ideali për liri dhe besimi im te udhëheqësi politik Adem  
25 Demaçi se sa te këta luftëtarët që kanë qenë në Shtab të

1 Përgjithshëm që realisht unë nuk muj ta quaj fiktiv, se kanë  
2 qenë, por nuk kanë qenë të rregullt. Kjo është organogrami.  
3 PY. Thjesht po ju pyes sepse mendoj se si në grafikun e  
4 mëhershëm që pamë, kur u intervistuat lidhur me këtë, ju thatë  
5 që:

6 "Jam shumë i sigurt dhe unë do thoja që jam në gjendje që  
7 të dalloj një anëtar të Shtabit të Përgjithshëm se ku është ai  
8 në diagram, por ai vetë nuk e di se ku ishte, sepse ata nuk  
9 janë kujdesur për të krijuar një strukturë fizike ose një  
10 diagram teorike."

11 Kjo është analizë e juaja, Dëshmitar, apo jo? Domethënë  
12 për ta bërë strukturën të dukej shumë e organizuar?

13 PË. Kjo është paraqitja, pasqyra e një strukture çfarë duhet  
14 të ishte, nuk e ka pasë Shtabi i Përgjithshëm, s'ka pasë si ta  
15 dijë ku është, por ka ditë rolin e vet secili. Unë besoj që  
16 janë konë të vetëdijshëm. Për atë s'mundem me thanë se s'kanë  
17 ditë. Por nuk kanë pasë organogramë të tillë. Kjo organogramë  
18 është një pasqyrë se si duhet të ishte, dhe si të funksiononte  
19 Shtabi i Përgjithshëm. Është studim shkencor, si të gjithë  
20 ushtritë e botës.

21 PY. Sipas analizës tuaj, në magjistraturën tuaj ju mendoni se  
22 që kështu duhet të kishte qenë diagrama, kështu?

23 PË. Patjetër vetëm kështu ka mujtë me funksionu si duhet.  
24 Përndryshe s'kish qenë funksional.

25 PY. Kur u pyetët lidhur me këtë në intervistën tuaj, ju thoni

1 që:

2 "Ndoshta në realitet, kjo diagrame nuk ishte ekzaktësisht  
3 e njëjtë siç është këtu, por duhet të kishte qenë kështu, siç  
4 është këtu."

5 A ta kuptojmë këtë që linjat e raportimit që keni  
6 hartuar, domethënë, këto vizat e konsoliduara, domethënë, a  
7 mund ta kuptojmë që kështu duhet të kishin qenë, por jo se  
8 situata domosdoshmërisht ishte në terren kështu lloji?

9 PË. Z. Avokat, për ta spjegu sesi kanë lëvizë gjanat, vetëm  
10 film kishim mujtë, me një organogram lëvizjet dhe ndryshimet  
11 s'mund të bëhen. Duhet 30 organograma të ishin, edhe pak do të  
12 ishin. Ato kanë lëvizë, kanë ndryshu.

13 PY. Këtë doja që të theksoja, te kjo pikë do të dilja. Në  
14 mënyrë të tillë që të kuptonit se si funksiononin gjërat, në  
15 realitet do të duhen 30 diagrama ose organograma të ndryshme  
16 sepse gjërat ndryshonin herë pas here, kohë pas kohe, apo jo?

17 PË. Shumë shpesh.

18 PY. Mendoj që edhe titullin e një prej kapitujve që keni  
19 shkruar në librin tuaj, ia keni dedikuar këtij koncepti. Në  
20 qoftë se do më lejoni një çast, pra kemi një kapitull të tërë  
21 në librin tuaj që juve e titulloni "Strategjia e UÇK-së që  
22 është filluar paralelisht me zhvillimet e saj dhe në  
23 konfrontim me armikun."

24 A mund të na e shpjegosh çfarë ke dashë të thuash me këtë  
25 fjali, në mënyrë të tillë që Trupi Gjykses ta kuptojë pak më

1 tepër idenë?

2 PË. Normal, kur është paraqitë strategjia e luftës së UÇK-së,  
3 sidomos me fokus të veçantë në zonën operative të Pashtrikut,  
4 u dashtë që të ketë edhe vizualitet, pamje se si do të ishte  
5 organizume si do të ishte organogrami, si do të veprohej, si  
6 do të ishin përgjegjësitë e ndamë, dhe kjo është strategji,  
7 është program, për të realizuar fitoren kundër armikut. Këtë  
8 kam dashtë ta bëj.

9 PY. Këtë e kuptoj. A po thoni, apo a pranoni, a pajtoheni me  
10 mua që UÇK-ja po zhvillonte, po zhvillohej si forca e  
11 armatosur duke rekrutuar persona të rinj, duke krijuar  
12 struktura të reja dhe duke u marrë me armikun në atë kohë në  
13 kuadrin e të gjithë situatës së përgjithshme e cila në  
14 vazhdimësi e sipër, pra, ishte në ndryshim, a pajtoheni ju me  
15 këtë?

16 PË. Pajtohena, që UÇK-ja ishte në evoluim, ishte në  
17 organizim, në rritje, sidomos prej 1 prillit kur ka qenë  
18 thirrja për mobilizim të përgjithshëm. U dashtë të  
19 planifikohen dhe të mendohen edhe sistemimet kështu siç e kam  
20 mendu unë. Në 1 prill 1999, [Në Anglisht] *I'm sorry*. 1 prill  
21 1999.

22 PY. Por, në thelb, në themel, që nga prilli, nga fillimi i  
23 prillit të 1998, organizata nuk funksiononte nga, si  
24 organizatë me hierarki nga sipër-poshtë, por ishin xhepa-xhepa  
25 luftëtarësh të cilët organizoheshin dhe disa persona që



Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04765 (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson (Vazhdim)

Faqe 97

1 merrnin vetë role si komandantë lokalë, dhe ishte në zhvillim  
2 e sipër në evoluim e sipër paralelisht me luftën që kryhej me  
3 armikun serb, a është kështu, dëshmitar?

4 PË. Jo. Në radhë të parë nuk pranoj të quhet organizatë.

5 Ishte Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Ashtu ishte, xhepa-xhepa  
6 në fillim, deri në fund të marsit --

7 PY. Ju kërkoj ndjesë.

8 PË. -- nga marsi e mbas ka qenë e organizume. Vetëm zona  
9 operative e Pashtrikut ka pasë rreth 10.000 ushtarë. Ka qenë  
10 tamam e strukturume si duhet. Të armatosur të gjithë kanë  
11 qenë, edhe të uniformuar, me emblemë, me uniformë, me komandë,  
12 me të gjitha. Domethënë, në situata, ju lutem, z. Avokat, ta  
13 kuptoni evoluimin.

14 PY. E kuptoj. Pra, po merremi me pjesë të ndryshme të  
15 Kosovës, dhe me mënyra të ndryshme organizimi në pjesë të  
16 ndryshme, a është e saktë kjo?

17 PË. Është shumë e vërtetë. Unë flas gjithmonë për zonën time,  
18 ku unë kam qenë komandant, nuk po them tash veç luftëtar, por  
19 e them një çlirimtar. Nji komandant që me nder, respekt dhe me  
20 sukses kam udhëheqë divizionin tim, që për popullin tim unë të  
21 jem hero. Për juve nuk di çka dukem këtu.

22 PY. Por ju keni menduar me shumë thellësi sa i takon mënyrës  
23 së organizimit. Ishit një lloj strategu ushtarak, po mendoni  
24 se si të organizonit zonën e Pashtrikut nën kontekstin ose në  
25 atë çfarë juve i quanit si lara leopardi, apo jo?

1 PË. Kur flas për larat të leopardit dhe kur flas për  
2 kontestin e përgjithshëm, unë kam pasë të drejtë të mendoj për  
3 të gjithë Kosovën dhe për të gjithë UÇK-në. Por përgjegjësinë  
4 time e kam nda me të tjerët siç e kam pasë unë në zonën time  
5 dhe kam rrujtë 200.000 civilë, kam mbrojtë, kam ushqye, i kam  
6 shërue, i kam strehue, dhe i kemi mbrojtë fizikisht. Kanë  
7 mujtë edhe zona të tjera ta kenë kështu, që shtatë zona kah  
8 200.000 t'i kishin mbrojtë, një milion e gjysmë civilë ishin  
9 mbrojtë në Kosovë. Por s'ka mujtë të gjithë ta kenë, as  
10 nivelin e organizimit, as sasinë, as terrenin e njëjtë të  
11 përshtatshëm, as aftësitë organizative, as gatishmërinë. Mos e  
12 teprova.

13 PY. Dhe, për pasojë besoj se e pranoni se panorama në nivel  
14 kombëtar ishte e tillë që organizimi në nivel vendor varej nga  
15 njerëzit, domethënë sa të mirë, sa të aftë ishin njerëzit në  
16 zonat përkatëse, apo jo?

17 PË. Shumë e drejtë, shumë e drejtë.

18 PY. Pra, në zonën e Pashtrikut ata ishin me fat që kishin  
19 dikë si puna juaj, që mendonit për diçka të tillë si  
20 strategjia ushtarake, por në zona të tjera situata ishte shumë  
21 tepër kaotike, a pajtoheni me mua dëshmitar?

22 PË. Pajtohena plotësisht. S'e kemi zgjedhë ne atë situatë.

23 Ashtu na u ka imponu.

24 PY. Por, i takon që nuk ka pasë ndonjë organ kombëtar që mund  
25 të organizonte gjërat në mënyrë konsistente ose të

1 njëtrajtshme në atë nivel hollësie në të gjithë Kosovën, besoj  
2 pajtoheni me mua, me këtë?

3 PË. Pajtohem. Zakonisht luftat i udhëheq ndonjë parti  
4 politike e cila ka konceptin e luftës dhe politikat e luftës,  
5 e cila angazhon ekspertët dhe njerëzit që janë të mirëfilltë  
6 të njohur me artin ushtarak dhe i bën këto programe, statute,  
7 rregulla, ligje. Por në Kosovë këto kanë munguar, nuk ka pasë.

8 PY. Ju keni thënë në dëshminë tuaj dy ditë përpara, se keni  
9 marrë vetëm dy urdhra nga Shtabi i Përgjithshëm. Një urdhër që  
10 kishte të bënte me mobilizimin e përgjithshëm, dhe urdhri i  
11 dytë nuk më kujtohet, ma kujtoni dot, Dëshmitar?

12 PË. Urdhri i dytë ka qenë me u kujdes për civilët e Kosovës  
13 sepse ka filluar granatimi i NATO-s dhe do të hakmerren forcat  
14 serbe ndaj civilëve, t'i rujmë ata dhe t'i mbrojmë. Dhe i kemi  
15 ba, ashtu kemi ba, kemi mbrojtë.

16 PY. Mendoj se mund të themi, për shembull, që këto urdhra të  
17 jenë dhënë pas 24 marsit, pas fillimit të bombardimeve ose  
18 granatimeve të NATO-s. A mund të na thoni përafërsisht sa pas  
19 granatimeve të NATO-s kanë ardhë këto urdhra?

20 PË. Urdhri për mobilizimin e përgjithshëm është më 1 prill,  
21 besoj që të njëjtën kohë edhe urdhri tjetër ka qenë, të  
22 interpretuar përmes Radios Kosova e Lirë. Nuk kemi marrë asgjë  
23 me shkrim, por e kemi kuptuar që është i rëndësishëm dhe e  
24 kemi zbatuar.

25 PY. Pra, si në fillim të prillit, të dyja, pra kanë ardhur

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04765 (Vijon) (Seancë e hapur)

Page 100

Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson (Vazhdim)

1 pas fillimit të prillit, pas Rambujesë, pas granatimeve. Dhe  
2 në të njëjtën kohë kur ka pasë ndryshime në Shtabin e  
3 Përgjithshëm dhe me, paralelisht me formimin e qeverisë së  
4 përkohshme, e saktë kjo?

5 PË. Sigurisht, në atë kohë ka pasë ndryshime në Shtab të  
6 Përgjithshëm.

7 PY. Lidhur me këtë temë, dua të kuptoj natyrën e  
8 komunikimeve. Nuk e kam fjalën për urdhrat, por e kam fjalën  
9 për komunikimet që keni pasur ju me anëtarë të Shtabit të  
10 Përgjithshëm. Besoj se në intervistë i keni thënë Prokurorit  
11 që kryesisht komunikimet ishin diskutime, ndërmjet jush ose  
12 komandantit të zonës, dhe kur arrijmë në mars, në përgjithësi  
13 përshtypja juaj ishte që pika e kontaktit ishte Bislim Zyrapi,  
14 shefi i shtabit, a është e saktë kjo dëshmitar?

15 PË. Po ju bënët shumë pyetje. Unë, përgjigja ime është veç me  
16 një "po" për Bislimin ngelet. Për ato të tjerat, komunikimi në  
17 nivel të zonës është bo nëpërmes brifinge që kemi pasë brifing  
18 në zonë. Dhe jemi njoftuar mes veti, dhe përmes radiolidhjeve,  
19 sepse në nivel të zonave radiolidhjet mund ta kapnin pesë  
20 kilometra, gjashtë, katër, kështu simbas terrenit. Ndërsa  
21 komunikimi me Shtabin e Përgjithshëm apo me ministrinë e  
22 përkohshme, është kanë i vështirë shumë se një telefon ka qenë  
23 në nivel të zonës, Tahir Sinani ka pasë një telefon satelitor.  
24 Unë e kam shfrytëzuar një katër-pesë herë, për me i dhanë  
25 koordinata NATO-s, NATO-ja me goditë forcat armike. E kam

1 shfrytëzu atë telefon nëse ka rastisë me qenë në komandë.  
2 Përndryshe Tahiri ma shumë e kam mbajtur me vete telefonin, dhe  
3 ai ka komunikuar, nuk e di sa ka komunikuar i rregullt. Sa i  
4 përket komunikimit, kjo është. Edhe pos kësaj ka qenë  
5 KosovaPress-i si gazetë e jona, dhe ka qenë Kosova e Lirë,  
6 Radio Kosova e Lirë. Më duket e qartësova.

7 Z. EMMERSON: [Përkthim] A mund të shohim shkurtimisht  
8 provën materiale P707.2. Është pjesa e dytë e intervistës  
9 tuaj. Faqja 9, rreshti 10. Më falni një çast, ju lutem. Është  
10 faqja 9, rreshti 10. Ju kërkoj ndjesë, më dhanë numra të reja  
11 tani, atëherë, është faqja 10, rreshti 10. Ndërkohë që në  
12 shqip duhet të jetë faqja 10, rreshti 1. Ju kërkoj ndjesë, a  
13 mund të kthehem tek faqja 9, ta shohim aty. Mirë, në rregull,  
14 do ta lë këtë çështje, do ta lë këtë pikë. Faleminderit.

15 DËSHMITARI: Merreni ashtu siç është te Prokurori, ju  
16 lutem. Nuk ka ndryshim, asgjë.

17 Z. EMMERSON: [Përkthim]  
18 PY. Po, po, absolutisht kështu. Megjithatë le ta bëjmë  
19 ndryshe. T'ju pyes, ajo çfarë i keni thënë Prokurorit është që  
20 ju kishit biseda, ose briefingje me Bislime Zyrapi dhe ju bëhet  
21 pyetje, lidhur me kohë që nuk kanë të bëjnë vetëm thjesht me  
22 operacionin Shigjeta, por dhe me periudha:

23 "Më përpara sesa kjo, çfarë informacioni ju ose persona  
24 të tjerë në zonë keni diskutuar me z. Zyrapi?

25 Dhe ju jeni përgjigjur si më poshtë:

1 "Kur ai ka marrë pjesë në këto brifingje, jo në të  
2 gjitha, por nuk është se ka marrë pjesë gjithmonë, por ka  
3 marrë pjesë në disa raste, ai na informonte neve për situatën  
4 e përgjithshme në zonë, lidhur me UÇK-në dhe në qoftë se  
5 informacioni, dhe na thoshte çdo lloj informacioni që ai  
6 kishte lidhur me forcat armike."

7 Pastaj pyetja që ju bëhet është kjo:

8 "Po ju, apo kolegë të tjerë nga komanda e zonës, çfarë i  
9 komunikoni z. Zyrapit?

10 Përgjigjja që ju jepni është kjo:

11 "Shumë pak informacion i jepnim, sepse i kishim mundësitë  
12 e kufizuara, sepse komunikimet me radio ishin të përgjuara,  
13 ndërkohë që ishte e vështirë që të dërgonim një korrier sepse  
14 zona, pjesa dërrmuese e zonës ishte e kontrolluar, 8 për  
15 qind", thuhet këtu, "pra ishte e kontrolluar nga serbët. Pra  
16 domethënë ngjante si me larat e leopardit", të cilat i  
17 trajtuam edhe më herët gjatë pyetjeve.

18 Pra, juve pyeteni, për çfarë periudhe e keni fjalën këtu?  
19 Dhe ju në përgjigje thoni që konfirmoni se bëhet fjalë në  
20 kohën kur ju keni qenë zëvendëskomandant i zonës, pra ky ka  
21 qenë qëndrimi, kjo ka qenë situata, domethënë pjesa më e madhe  
22 e brifingjeve ose komunikimeve ishin diskutime me z. Zyrapit  
23 lidhur me situatën e përgjithshme, a është e vërtetë kjo,  
24 dëshmitar?

25 PË. Sado që çoni diskutime të gjatë, shumë fishekzjarre, për

1 nji pikë të caktume, po i bëni. Aty 8 ku e keni, korigjoheni,  
2 është 80 për qind. 8 për qind nuk është e saktë, 80.

3 PY. Kështu mendova edhe unë, por ngaqë ishte 8 aty jua thashë  
4 8 prandaj.

5 PË. Jo se është shumë, shumë e - mbrapshtë del ajo. Këtu që  
6 ne e bënim me Bislimin është e vërtetë që kishte pak  
7 informacione sepse ishin sulme në të gjitha anët, e kjo etapë  
8 ka qenë, ku unë kam qenë ndihmës-komandant për çështje morale  
9 e politike. Jo zëvendëskomandant, jo zëvendëskomandant.

10 PY. Më prisni një çast, nuk e di.

11 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ka ndonjë problem?

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Krasniqi  
13 është larguar nga ekrani, ja u kthye përsëri z. Krasniqi.

14 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë.

15 DËSHMITARI: Përshëndetje, baca Jakup.

16 Z. EMMERSON: [Përkthim] Faleminderit për këtë sqarim.

17 PY. Dëshiroj të shohim një ose dy dokumente të tjera. Kam  
18 përshtypjen që ju është bërë pyetje për këto dokumente nga  
19 Prokuroria një herë ose dy herë. Thjesht disa pyetje sqaruese  
20 lidhur me këto.

21 Z. EMMERSON: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares të  
22 fillojmë - vetëm një çast - që të paraqesë dokumentin P00164,  
23 pra provën materiale 164. Duhet të jetë dokumenti U002-2800  
24 deri në 2822 që është përkthimi në anglisht. Ndërkohë versioni  
25 i përkthyer është ET, me versionin ET në fund.

1 PY. Është një version që Prokuroria jua ka dërguar gjatë  
2 intervistës me të. Siç mund ta shikoni nga ekrani është  
3 dokumenti që mban titullin "Lufta speciale" dhe mban datën e  
4 nëntorit 1998. Nuk e di në qoftë se ju kujtohet që ju është  
5 treguar ky dokument, por ka të bëjë me rëndësinë e kontrollit  
6 të narrativës në luftë asimetrike. A ju kujtohet ta keni parë  
7 këtë dokument?

8 PË. E kam pa këtë dokumentin, e kam parë nga, Prokurori ma ka  
9 prezantu. Ky është një dokument i organizatës Lëvizja  
10 Kombëtare Çlirimtare e Kosovës, LKÇK. Dhe ajo organizatë qysh  
11 para luftës, ka mendu në këtë drejtim, ka shkru një broshurë.  
12 Kjo broshurë është, gjithë diku në Suharekë, apo Budakovë,  
13 s'po e di në cilin fshat, por është nënzonës së Llapit. Nuk ka  
14 të bëjë me zonën operative të Pashtrikut. Gjatë leximit të  
15 materialit unë pashë që s'është materiali i jem. Kur e pamë në  
16 fund atje, e keni në fund, të nënvizume. Nënzona e Llapit,  
17 nënzona e Llapit. Në fund, në faqen e fundit.

18 PY. E di që ju janë bërë pyetje lidhur me këtë dokument, por  
19 në fazën që janë bërë pyetjet, nuk ishit i sigurt në qoftë se  
20 e keni shkruar apo jo. Por ju e keni lexuar këtë dokument, apo  
21 jo, dëshmitar?

22 PË. E kam lexu pasi më ka tregue Prokurori, e kam lexu këtu.  
23 Në Hagë e kam lexu.

24 PY. A pajtoheni me mua që bëhet fjalë për një përshkrim të  
25 përgjithshëm të luftës propagandistike, për propagandë?



Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04765 (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson (Vazhdim)

Faqe 105

1 PË. Ka qenë një grup i vogël, LKÇK-ja që e ka qujtë veten,  
2 nuk ka qenë LPK, dhe ata e kanë pasë bazën e organizimit pak  
3 ma me ideologji të theksime. Dhe shprehja që gjeta kur e  
4 lexova ishin ma ekstreme, përnjëherë rashë në kundërshtim me  
5 to. Thashë, ky dokument nuk është i imi nuk është i zonës  
6 operative të Pashtrikut, nuk e kam pa në luftë, se ku është  
7 dorëzu pas lufte, pas lufte u dorëzu në TMK, në Prizren. Dhe u  
8 gjet në zyrën e Halil Qadrakut kur u bë bastisja e zyrës së  
9 Halilit, të zonës.

10 PY. Ndaloni për një çast, ju lutem. Të shohim faqen 002-2805.  
11 Dhe pasi e keni lexuar thjesht dua që të konfirmoni së pari  
12 natyrën e dokumentit. Pra, ka një titull këtu që thuhet,  
13 "Lufta propagandistike". Përmbajtja ka të bëjë me përdorimin e  
14 informacionit në kontekstin e konfliktit të armatosur, apo jo  
15 dëshmitar? Domethënë, për të kapur mendjet dhe zemrat e  
16 njerëzve, kështu?

17 PË. Unë -- jam në gjendje t'ju fol me orë të tëra për luftën  
18 speciale, kolonën e pestë, spiunët e shteteve të ndryshme. Ju  
19 lutem nuk merrena me këtë dokument, nuk është i atij niveli.  
20 Nuk është, nuk dua ta komentoj dokumentin. Për mue s'është  
21 valide as atëherë, as sot, as ka hy në funksion asnjherë.

22 PY. Në rregull, në rregull. Po e lëmë atëherë dokumentin.  
23 Megjithatë dua t'ju bëj pyetje në lidhje me një dokument i  
24 cili quhet "Ushtria Çlirimtare e Kosovës Rregullorja  
25 disiplinore Prishtinë 1998 -- Rregullorja e disiplinës e

1 Shtabit të Përgjithshëm". Do të bëjmë një pyetje në lidhje me  
2 këtë dokument. Dhe ju jeni pyetur për këtë në intervistën  
3 tuaj.

4 Z. EMMERSON: [Përkthim] Jam i sigurt. Kemi numrin  
5 P000715.

6 DËSHMITARI: Unë nuk besoj që ka pasë rregullore Shtabi i  
7 Përgjithshëm. Këto rregullore i kemi bo ne në zonën operative  
8 të Pashtrikut. Tri rregullore kanë qenë. Nëse keni ma shumë  
9 ju, s'besoj tjetërkund që kanë pasë, as zona të tjera. Se  
10 niveli i organizimit ka qenë ma i madh në zonën operative të  
11 Pashtrikut.

12 Z. EMMERSON: [Përkthim]

13 PY. Atëherë, a mendoni ju që ky dokument ka dalë nga niveli i  
14 zonës në Pashtrik?

15 PË. Po.

16 PY. Mbani mend ta keni parë si u krijua, si u hartua ky kur  
17 keni qenë në Pashtrik, apo nuk e dini?

18 PË. Unë e di që kam dhanë materiale për krijimin e këtyne  
19 rregulloreve. Dhe kur është shtypë, pastaj s'e kam kontrollu  
20 ma. E kam pa këtu. Por nuk mund të hjeki dorë që nuk është  
21 dokumenti im.

22 PY. Jo, domethënë nuk do të thoshit që nuk është dokumenti  
23 juaj, këtë po thoni?

24 PË. Unë po them se është i komandës të zonës operative të  
25 Pashtrikut. Tri rregullore janë: rregullorja disiplinore,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04765 (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson (Vazhdim)

Faqe 107

1 rregullorja rreshtore, dhe rregullore për objektet e rëndësisë  
2 të veçantë dhe për policitë. Tri rregullore në nivel të zonës,  
3 këto rregullore janë gjetë në arkivin e UÇK-së në zonën  
4 operative të Pashtrikut kur është bë bastisje.

5 PY. A mund ta shpjegoni që pse atëherë ky dokument ka lart  
6 "Ushtria Çlirimtare e Kosovës, Shtabi i Përgjithshëm", ka qenë  
7 një projekt propozim, pra një version i një propozimi për  
8 shembull nga zona për Shtabin e Përgjithshëm?

9 PË. Sigurisht, kjo është bë e një niveli të përgjithshëm dhe  
10 ju ka dorëzu edhe Shtabit të Përgjithshëm, por nuk di e ka  
11 marrë a s'e ka marrë kush.

12 PY. Në rregull. Ndoshta të shikojmë pak më shumë hollësi nëse  
13 mundemi. Ne shikojmë nga organogrami juaj që Nuredin Abazi ju  
14 na keni thënë ishte jurist, i cili ishte këshilltar për zonën  
15 e Pashtrikut dhe ju e keni njohur atë që kur keni qenë  
16 komandant brigade në fillim të shërbimit tuaj. Ka qenë i  
17 përfshirë ai në këtë gjë?

18 PË. Sigurisht është kanë edhe ai i konsultumë, por unë kam  
19 pasë shumë njohuri edhe pse s'jam kanë magjistër atëherë,  
20 njohuri juridike. Kam lexu shumë rregullore të shteteve të  
21 ndryshme, dhe jam bazuar në shumicën e tyre.

22 PY. Dhe ju keni thënë që këto materiale ia dhatë dikujt. Ose  
23 thjesht që të jem i qartë, a i keni shkruajtur ju vetëm këto  
24 rregulla apo këto materiale ia keni dhënë dikujt tjetër që t'i  
25 shkruajë? Apo i keni shkruar me dikë tjetër, me Nuredin

1 Abazin?

2 PË. Unë nuk kam pasë, nuk kam pasë kompjuter, të them të  
3 drejtën. S'kam pasë laptop. Laptop, kena pasë një laptop krejt  
4 zona. Aty është punu. Tahir Sinani ka punu, Nuredin Abazi,  
5 Halil Qadraku edhe unë. Unë kam dhanë materiale të shkrueme, me  
6 shkrim, e janë bartë këtu.

7 PY. Atëherë, ju lutem më lejoni pak që të lexoj transkriptin.  
8 Pra se çfarë u tha. Ju lutem një çast.

9 Pra, z. Sinani. Por ju na thatë që z. Sinani nuk ishte  
10 emëruar, nuk u emërua në zonë deri në pjesën e dytë të marsit,  
11 por në dokument data është 1998 -- ja një sekondë t'jua bëj  
12 pyetjen sërish.

13 Pra, ju na thatë që z. Sinani nuk u emërua si komandant i  
14 zonës deri në mars 1999. A mund të na thoni pse data është  
15 Prishtinë 1998?

16 PË. Sigurisht, shkrimet tona kanë shku në zyrën e Adem  
17 Demaçit atje, dhe kanë mundun atje të bëhet shtypi. Tahir  
18 Sinani ka hi më 24 nëntor në Kosovë, nuk ka qenë ma herët, të  
19 1998, se po harrojmë vitin. Po harrojmë vitin.

20 Z. EMMERSON: [Përkthim] A mund të bëjmë një pauzë të  
21 shkurtër, se nuk po shikojmë dot transkriptin. E kam të saktë  
22 këtë gjë apo jo? Po, po.

23 PY. Duhet të presim pak për transkriptin në rast se nuk e  
24 keni problem, ju lutem. Një çast.

25 PË. Vazhdoni me pyetjet z. Avokat, pa problem, unë ju

1 përgjigjem.

2 Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk mundem, nuk mundem.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet të kemi  
4 patjetër transkriptin në ekran përpara nesh.

5 Z. EMMERSON: [Përkthim] Sepse përgjigjet tuaja nuk po  
6 mbahen në transkript, nuk janë paraqitur.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani  
8 transkripti në ekranin tim funksionon, duket që po funksionon.

9 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po, jemi rikthyer.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të  
11 vijojmë nga aty ku e kishim lënë?

12 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,  
14 vazhdoni.

15 Z. EMMERSON: [Përkthim]

16 PY. Pra, z. Sinani, ju dhe z. Abazi dhe -- ndjesë, personi  
17 katërt i përfshirë kush ka qenë, a mund të më kujtoni?

18 PË. Halil Qadraku, Sadik Halitjaha, Nuredin Abazi, Tahirin po  
19 e eliminojmë nëse është para asaj kohe, nëse s'ka mbërri hala.

20 Por sigurisht që ka dhënë kontribut dikund në dokumenta të  
21 tjera. Ky material ka shku në zyrën e Adem Demaçit në

22 Prishtinë dhe atje ka marrë formën telegrafike dhe formën si

23 broshurë që shihet kështu. Se ne s'kemi pasë, një laptop kemi  
24 pasë krejt në zonë.

25 PY. Në rregull. Atëherë që të jemi të qartë, materialet që

1 keni përdorur ju duket sikur janë marrë nga një ushtri  
2 tërësisht tjetër, për shembull nga ushtria jugosllave, është e  
3 saktë kjo? Se ju thatë që keni parë për shembull rregulloret e  
4 shumë -- ndoshta jo të Jugosllavisë, por ndonjë ushtrie  
5 tjetër.

6 PË. Jo, ka mundësi prej Shqipërie me pasë, diçka të tillë.  
7 Jugosllave, mos na fy, mos na fy z. Avokat, të lutem.

8 PY. Ndjesë, ndjesë. Ju kërkoj ndjesë. Thjesht po eksploroja  
9 këto gjëra tani, por kanë ardhur nga ushtri të tjera, ushtri  
10 të vendeve të tjera --

11 PË. Po, po, ashtu është.

12 PY. -- është e saktë kjo?

13 PË. Ashtu është.

14 PY. Dhe nga një vend, nga një shtet tjetër apo më shumë se  
15 një shtet.

16 PË. Varësisht njerëzit sa kanë lexue. Dhe njohuritë sa i kanë  
17 pasë të hapura. Nëse unë për shembull kam njoftë disa sisteme,  
18 sistemin jugosllav, shqiptar, të Shqipërisë, francez, rus, e  
19 shumë të tjerë, nja shtatë-tetë sisteme, kam ardhë te një  
20 mundësi me ia përshtatë kushteve dhe rrethanave tona. Dikush e  
21 ka ditë një orientim tjetër, dikush tjetër, janë bashku. Është  
22 kriju rregullorja.

23 PY. E kuptova, pra është një farë shkrirjeje, të themi, i  
24 rregullave nga vende të tjera, që janë marrë të ndryshme. A  
25 mund të shpjegohet kështu, për shembull?

1 PË. Po, po.

2 PY. Dhe kjo mund të shpjegojë dhe disa nga anomalitë, për  
3 shembull, në të.

4 Z. EMMERSON: [Përkthim] Për shembull, le të shikojmë, ju  
5 lutem, nëse mundemi -- faqja, nuk e di si është më lehtë, por  
6 faqet e brendshme, faqja 3, e dokumentit. Nëse mund të shikojmë  
7 tek faqja 3, ju lutem. Më duket se kam përdorur numrat e  
8 duhur.

9 PY. Por, po të shikojmë për shembull, paragrafin 2,  
10 përkufizimin e një personi ushtarak. Dhe në paragrafin 2a.:

11 "Oficerët e shërbimit aktiv të UÇK-së dhe të Forcave  
12 territoriale të UÇK-së, të rendit publik të themeluar nga UÇK-  
13 ja dhe të shërbimit informativ të Kosovës..."

14 Dhe tani të kalojmë te faqja tjetër ju lutem.

15 "... dhe oficerët rezervë të tyre kur janë në shërbim  
16 direkt të UÇK-së.

17 "b. Nënoficerët e shërbimit të detyruar" --

18 PË. Qartë është -- qartë z. Avokat. Kjo është kopje e asaj të  
19 Shqipërisë, s'ka pasë as rezervë as -- është një kopje pas --  
20 nuk du me --

21 PY. Ose flet për forcat territoriale.

22 PË. Nuk du me e banalizu, por kushtetutën kur e kanë aprovu,  
23 e kanë aprovu në Shqipëri në kohën e Sali Berishës, kanë thanë  
24 se nuk duhet të atimohen nëndetëset bërthamore kur dalin nga  
25 Shqipëria. Ku ka Shqipëria nëndetëse bërthamore? E kanë kopju

1 prej anglezëve edhe kështu ka dalë. Edhe kjo është një kopje  
2 pasi -- është e pasaktë, është e pasaktë.

3 PY. Megjithatë, është ende e rëndësishme që ta sqarojmë këtë  
4 gjë, sepse ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në çështjen  
5 që ngre Prokuroria. Te 2b. përfshihen:

6 "...oficerët e shërbimit të detyrueshëm aktiv dhe në  
7 rezervë kur janë duke kryer shërbimin në UÇK."

8 Nënoficerët e shërbimit të detyrueshëm, çfarë do të thotë  
9 kjo në kontekstin e UÇK-së?

10 PË. Nuk -- s'kam dashë ta zgjasni se nuk e ka kurrfarë  
11 relevance, s'ka pasë as oficerë, as nënoficerë, ne në UÇK-  
12 s'kemi pasë grada. Kemi pasë ndarje detyra, përgjegjësisë,  
13 edhe kështu është. Kështu është, të lutem.

14 PY. E kuptoj. E kuptoj, ndoshta përse po buzëqeshni, sepse  
15 për ju është shumë më e qartë sigurisht. Por nuk ka qenë e  
16 qartë për Prokurorinë të cilët e kanë bazuar pjesën më të  
17 madhe të çështjes së tyre për këtë dhe as nuk kanë dëshmuar  
18 për shembull autorët e saj dhe thjesht është bërë sikur është  
19 pjesë ose punë e Shtabit të Përgjithshëm.

20 Z. PACE: [Përkthim] Ky ishte koment i përgjithshëm,  
21 kundërshtoj.

22 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ishte thjesht për të thënë që nuk  
23 është ndoshta që ta shikojë për përgjigjen dhe dëshiroj të  
24 flas me dëshmitarin për këtë gjë.

25 PY. Më falni. Do të duhet që të vijojmë edhe pse ju e kuptoj



1 që buzëqeshni se e kuptoni vetë këtë gjë.

2 Po tek 3:

3 "Personeli ushtarak gëzon të drejtat që kushtetuta u njeh  
4 shtetasve".

5 Po cila kushtetutë, për cilën kushtetutë u referoheni  
6 këtu?

7 PË. Po vetë ky fakt tregon se Kosova s'ka pasë kushtetutë  
8 deri më aprovimin e kushtetutës më 2008, a 2009, kur e kemi  
9 aprovu, mbas shpalljes së pavarësisë. Nuk ka pas kushtetutë  
10 Kosova, s'ka pasë parlament, s'kemi pasë ligje. Nuk na kish hy  
11 në punë kjo fare as atëherë as sot nuk na hyn.

12 PY. Atëherë të shikojmë disa shembuj të tjerë nëse mundemi.

13 Z. EMMERSON: [Përkthim] Mund të shikojmë te faqja 15, e  
14 brendshme.

15 PY. "Ushtarët dhe ushtarët e shërbimit të detyrueshëm, do të  
16 jepen këto lloj shpërblimesh", besojmë, besojmë që janë  
17 shpërblime, dhe shpjegohet lista që nga për shembull një  
18 shpërblim financiar, dekorata, dhe shikojmë tek numri 2:

19 "Për ushtarët dhe nënoficerët rezervistë, jepen  
20 shpërblimet e mësipërme, me përjashtim të germave c dhe f".

21 Në fakt kjo s'ka të bëjë fare me realitetin, siç ishte në  
22 të vërtetë, apo jo?

23 PË. S'ka të bëjë me realitetin kurrgjë dhe nuk kam pse bëjmë  
24 analizë kësaj pune. Kjo bie poshtë komplet, dhe nuk është  
25 përdorë si e tillë se s'ka pasë as ushtarë rezervë, as

1 dekorata, as kushtetutë, as ligje nuk ka pasë. Na jemi  
2 dëshmitarë të asaj kohe. Unë jam protagonist në lëvizjet për  
3 çështje atdhetare prej 1977. 1979 kam qenë i burgosur për herë  
4 të parë. Krejt protagonizmi ka zgjatë edhe në luftën e UÇK-së.  
5 Këto s'ka pasë kurrgjë të kësaj natyre çka thuhet.

6 PY. Nëse është e mundur, më duroni dhe pak çaste. E kam  
7 kuptuar dëshminë tuaj dhe është skajshmërisht e rëndësishme  
8 kjo, kështu që ju lutem, edhe pak çaste.

9 Nëse mund të shohim faqen 16, ju lutem, kur kemi edhe  
10 një, shikojmë edhe një hierarki të niveleve të komandës, dhe  
11 mundësia për të dhënë për shembull shpërblime të ndryshme.

12 Ku tek 1, është komandanti i skuadrës, pastaj kemi  
13 komandantin e togës, tek 2. Dhe po të kalojmë tek faqja tjetër  
14 ju lutem. Faqja 17, 3, komandanti i kompanisë. 4, komandanti i  
15 batalionit. Dhe 6 -- dhe mund të shikojmë gjithashtu tek 6, që  
16 trupa kryesore është divizioni, gjithashtu dhe marina  
17 shqiptare, ose aviacioni shqiptar.

18 I bie atëherë që këto thjesht nga rregullorja e  
19 Shqipërisë janë marrë dhe kanë kopjuar fiks dhe ju menduat se  
20 ky mund të ishte formati i duhur, apo jo?

21 PË. Mu më vjen keq që s'e kam pa me kohë, përndryshe kjo  
22 ishte grisur, ish shkyer. Se nuk na ka hy në përdorim kurrkund  
23 edhe s'ka pasë asgjë reale atë çka shpjegon kjo. Ka shpëtu  
24 atëherë në luftë, nuk kena mujtë me i përcjellë të gjitha, dhe  
25 me i kontrollu të gjitha anët teorike. Ma shumë e kemi pasë

1 punën praktike me armikun.

2 PY. Dhe po të shkojmë sërish te faqja 5, paragrafi 3, faqja e  
3 brendshme 5, paragrafi 3, po lexoj fragmentet e para për ju.

4 3, 1.:

5 "UÇK-ja ka ndërtim hierarkik. Në marrëdhëniet midis tyre  
6 ushtarët kanë eprorë dhe vartës. Kjo përcaktohet nga hierarkia  
7 e detyrave dhe e gradave.

8 "2. Hierarkia e gradave përcaktohet me rregullore të  
9 posaçme. Ajo shpreh lidhjen mes detyrës dhe ruan nga një gradë  
10 në tjetrën raportin e më të lartit me më të ulëtin.

11 Edhe kjo është marrë nga manuali, apo doracaku i  
12 disiplinës së ushtrisë shqiptare?

13 PË. Është marrë nga ajo. Nuk ka pasë grada UÇK-ja. S'ka pasë  
14 grada. Unë kam qenë zëvendëskomandant zone. Normal, në kushte  
15 paqe, duhet me qenë një gjeneral. Aty s'kemi pasë kurrkush  
16 grada. As ka pasë Tahiri grada, as unë, as ata ma poshtë ata  
17 ma naltë, asnjë s'ka pasë grada gjatë luftës.

18 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ju kërkojmë ndjesë, kemi problem  
19 sërish me transkriptin sepse ndaloi për pak çaste. Në rregull  
20 jemi tani.

21 PY. Po, dhe ju na thatë pra që edhe ata që kishin funksione,  
22 pozicione, siç i keni shpjeguar ju, nuk është se mund ta dinin  
23 se si cili ishte vendosja e tyre në hierarkinë e përgjithshme  
24 apo jo?

25 PË. Është e mundshme që mos ta din ai, detyrën e vet në

1 funksionin që ka pasë. Përndryshe dikush është dashtë ta  
2 sqarojë edhe u dashtë me e ditë funksionet. Ashtu është, siç e  
3 thatë ju. Siç e thatë ju.

4 PY. Pra --

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emmerson,  
6 pak më me ngadalë, ju lutem.

7 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ja, do të ndaloj pak.

8 PY. Atëherë, ky dokument ishte ideja e grupit tuaj në  
9 Pashtrik se si do të ishte ideja e një ushtrie në rast se ajo  
10 do të kishte dhe rregulloret e një ushtrie normale të një  
11 shteti?

12 PË. Jo veç ide, por ka qenë edhe tentativë me qenë një  
13 strategji e tillë, një projekt i tillë, një program i tillë.  
14 Por nuk janë realizu gjanat, kanë mbetë në tentativë. Në  
15 tentativë kanë mbetë, kjo është.

16 PY. Po në rast se dikush do të mendonte se ky dokument në  
17 çfarëdo forme mund të ishte në fakt një përshkrim i saktë i  
18 realitetit në terren, i luftës së UÇK-së kundër Serbisë,  
19 atëherë do ta kishin shumë gabim, apo jo, në rast se do ta  
20 merrnin literalisht, siç ishte, siç është kështu?

21 PË. Kjo nuk është përdorë, po të ish përdorë është absurde,  
22 se ku është aviacioni, ku janë nëndetëset, ku është ushtria e  
23 rregullt? Jo, s'ka të bëjë ajo. S'ka të bëjë me funksionet.

24 PY. Dhe si dikush që punonte për moralin, te njësitë i  
25 moralit, ju jeni i kualifikuar që të bëni koment për pyetjen e

1 radhës që kam. Ne kemi parë edhe disa dokumente të tjera të  
2 UÇK-së që janë dhënë për shembull nga qershori 1999, që kanë  
3 emëruar persona si komandantë për armët kimike dhe biologjike,  
4 ose komandant për luftën bërthamore, ose për brigadën e  
5 tankeve. Ju keni parë gjë të tillë në terren?

6 PË. Ka qenë një togë, për çështje kundër helmimeve  
7 bërthamore, kundër luftës bërthamore. Ajo ka qenë tentativë si  
8 bërthamë që në të ardhmen me funksionu në ushtrinë e Kosovës.  
9 Me pasë edhe atë degë të çështjeve bërthamore. Përndryshe, na  
10 e dimë edhe sot ku është ushtria e Kosovës, në cilin nivel.  
11 Për projektet, nuk kisha dashtë të flasim sikur gjanat e  
12 kryera. Projektet janë projekte, qëllimet, qëllime, realiteti  
13 dhe të mbërrimet, atëherë flasim konkretet.

14 Ju mirë po bëni z. Avokat që po e sqaroni, por mu po më  
15 duket se po shkojmë shumë gjatë edhe, mund me i ra ma të rup  
16 rrugës, rrugës ma të rup i bijmë.

17 PY. Jam i sigurt që të gjithë të tjerët në Gjykatë janë  
18 dakord me juve.

19 Z. EMMERSON: [Përkthim] Atëherë, a mund ta vendosim në  
20 ekran, më lejoni një çast, ju lutem. Po, data 10 nëntor 2023,  
21 është Shënimi përgatitor numër 1, ju lutem të shfaqim në ekran  
22 faqen numër 6 të këtij dokumenti.

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dhe numri është P714.

24 Z. EMMERSON: [Përkthim]

25 PY. Pra ky është një shënim i cili është bërë gjatë takimit

1 më të fundit me z. Pace, kur jeni përgatitur për dëshminë  
2 tuaj, dhe dëshiroj t'ju bëj një pyetje për të gjithë  
3 paragrafin numër 25. Këtu përfshihet pjesa e organogrameve dhe  
4 materialeve të tjera të cilave ju kemi treguar.

5 PË. [Nuk ka përkthim]

6 PY. Fatkeqësisht nuk kemi përkthim në gjuhën shqipe sepse ky  
7 është një shënim i kohëve të fundit, por do ta lexoj me  
8 ngadalë shumë, në mënyrë që të arrihet përkthimi në këtë  
9 moment tani. Dhe pasi shikojmë këtu numrat e dokumenteve,  
10 vazhdohet duke thënë që:

11 "G1 deri te G6 raportonte te komandanti i zonës. Qadraku,  
12 i cili ishte te ZKZ-ja, raportonte te komandanti i zonës dhe  
13 Bislum Zyrapi".

14 Këtu thuhet që juve ju pyetën se pse më parë kishit thënë  
15 që z. Qadraku i raportonte shefit të shtabit dhe Kadri  
16 Veselit, dhe ju keni thënë që ju e dinit që J2, dhe pra Kadri  
17 Veseli në organogramën tuaj, ishte eprori i G2, por që nuk  
18 ishte e mundur që Qadraku të takohej me Veselin meqenëse  
19 Veseli nuk ishte në Kosovë që nga janari e deri në fund të  
20 luftës. Kur ju pyetën se nga e dinit ju që Veseli nuk ishte në  
21 Kosovë ndërmjet janarit dhe fundit të luftës, ju keni thënë që  
22 ju keni qenë tek Shtabi i Përgjithshëm në janar dhe z. Veseli  
23 nuk ishte aty. Dhe ju keni thënë që kur ai u kthye nga  
24 Rambujeja, nga zona e Pashtrikut, mundësisht duhet të ketë  
25 qenë prill, mund të ketë qenë prill, thatë ju, ju e morët me

1 makinë z. Veseli dhe që atëherë nuk e keni parë më. Duke  
2 shtuar që ju nuk e dinit se ku ishte z. Veseli dhe nuk keni  
3 marrë ndonjë raport që ai ka qenë në Kosovë.

4 Tani, a është e mundur që të bëni ndonjë koment për këtë  
5 fragment që ju lexova?

6 Z. PACE: [Përkthim] A mund të lexojmë edhe fjalinë e  
7 fundit në këtë paragraf?

8 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po.

9 PY. Ka edhe një fjali të fundit të cilën z. Pace kërkon që  
10 unë ta lexoj. Dhe fjalia e fundit nga fjalia e mëparshme vijon  
11 duke thënë që ju keni shtuar, që ju nuk e dinit se ku kishte  
12 qenë z. Veseli, nuk keni marrë raporte që ai ishte në Kosovë.  
13 Dhe që pastaj z. Pace ju ka pyetur zakonisht a merrnit raporte  
14 për ku ndodhej z. Veseli? Dhe ju keni thënë që jo, nuk prisnit  
15 që të bëhej kjo gjë.

16 Pra, ajo që po them unë, është që ju jeni i qartë në  
17 dëshminë tuaj për secilin prej këtyre pjesëve. Ju a e keni të  
18 mundur që të kontradiktoni propozimin që z. Veseli është  
19 larguar nga Kosova në kohën e riorganizimit të shtatorit,  
20 tetorit?

21 PË. Nuk mund ta konfirmoj se s'kam pasë njohuri. Unë për aq  
22 sa kam pasë njohuri e kam thanë, edhe nuk e heq asgjë nga kjo  
23 që kam thanë unë. Këtu shumë të drejtë është edhe fjalia e  
24 fundit, ku thotë, se nuk na ka dhanë raport. Z. Veseli s'ka  
25 pasë nevojë të na raportojë neve, po as na s'kena pasë nevojë

1 ta lypim dhe ta dijmë ku është. Nëse na ka vyjtë, sigurisht e  
2 ka lypë.

3 Por Halili e ka pasë ma lehtë t'ia dorëzoi materialet  
4 Bislimit, Bislim Zyrapi ka qenë ma afër zonës, por në shumicën  
5 e rasteve Tahir Sinanit, se Tahiri është kanë komandanti i  
6 zonës. Tahiri ka komunikuar me Bislimin. Unë nuk njoh ndonjë  
7 rast të veçantë se do ta konfirmoja menjëherë këtu, pak prej  
8 inatit që më ka idhnu dje, do të kisha thanë që i ka raportu,  
9 e ka ba kështu, e ashtu, për Kadri Veselin. Por s'kam në këtë  
10 pikë, s'kam asnjë -- duhet ta them të vërtetën.

11 Z. EMMERSON: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, e shoh çfarë  
12 ore është. Por nëse mund të kem edhe 10, 15 minuta kohë  
13 maksimalja.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, ne  
15 e përfundojmë këtu ditën e sotme dhe do të riktheheni nesër në  
16 mëngjes në orën 9.00 dhe do të vijojmë me dëshminë tuaj dhe me  
17 pyetjet që do t'ju bëhen.

18 Atëherë, ju lutem, nëse mund të --

19 Z. PACE: [Përkthim] Nëse është e mundur, që ta rikujtoni,  
20 i nderuar, dëshmitarin për faktin që nuk duhet të përsërisë  
21 asgjë që është thënë në sallë.

22 Z. EMMERSON: [Përkthim] Dhe besoj për këtë çështje që ju  
23 keni thënë, kjo duhet të bëhet --

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju do të keni  
25 mundësinë që të flisni me Zyrën Administrative për deklaratën



Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04765 (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson (Vazhdim)

Faqe 121

1 që bëtë në fillim të ditës së sotme.

2 Kështu që nëse është e mundur shkoni me Sekretaren e  
3 Seancës, por ne bashkë do të rishihemi në orën 9.00 të  
4 mëngjesit nesër.

5 Përveç me Zyrën Administrative këtë çështje nuk mund ta  
6 diskutoni me askënd tjetër, pra dëshminë tuaj këtu sot.

7 DËSHMITARI: Faleminderit, natën e mirë. Faleminderit.

8 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

9 Z. ROBERTS: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, por nuk vura si  
10 prova tre nga shënimet që janë bërë me dëshmitarin e  
11 mëparshëm. Dhe mendoj që mund ta bëjmë këtë tashmë në minutën  
12 e fundit. Dhe e kam informuar Prokurorinë.

13 Do t'ju lexoj dhe numrat përkatës të ERN-së. 108612,  
14 110768 dhe 116502.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
16 kundërshtim nga Prokuroria?

17 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar.

18 Z. EMMERSON: [Përkthim] Meqë ra fjala, dhe ndoshta këtë  
19 gjë mund ta bëjmë në seancë private.

20 Z. KEHOE: [Përkthim] Por përpara saj nëse mund të flas  
21 edhe unë, disa prova materiale dhe që janë të redaktuara për  
22 publikun.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nëse mund të  
24 na i jepni numrat.

25 Z. KEHOE: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, Gjyqtar.

1           SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Për ato tre prova që u  
2 dhanë nga Pala Mbrojtëse e z. Selimi, e para do të marrë  
3 numrin ERN 108612 deri në 108612 RED, dhe kjo është provë  
4 materiale 3D10.

5           E dyta, 112768 [Sipas përkthimit] Do të jetë prova  
6 materiale 3D11.

7           Ndërsa 116502 do të jetë 3D12.

8           Dhe a mund të sqaroj diçka për klasifikimin e tyre?

9           Z. ROBERTS: [Përkthim] Mendoj që duhet të jenë  
10 konfidenciale sepse u trajtuan në kontekstin, megjithëse jemi  
11 në seancë publike, por për procedurat që u diskutuan në seancë  
12 private, kështu që mendoj që është më mirë që të mbeten të  
13 klasifikuara si konfidenciale.

14          KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të mbeten  
15 të klasifikuara si konfidenciale për momentin.

16          Z. EMMERSON: [Përkthim] A është e mundur të kalojmë në  
17 seancë private që unë të flas për një çështje të caktuar, ju  
18 lutem?

19          KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, z. Kehoe  
20 mund të vijoni.

21          Z. KEHOE: [Përkthim] E kuptoj që neve po japim tashmë  
22 edhe dy prova që kemi dhënë. Janë redaktime që janë bërë për  
23 dëshmitarin 03825. Dhe janë redaktimet që janë bërë në  
24 konsultim me palët për ZPS-në.

25          Dhe këto kanë qenë shënimet përgatitore të ZPS-së për

1 3085, dhe janë 116768, deri në 116787, të redaktuara, dhe këto  
2 janë pranuar si 1D64. Dhe kjo ishte letra nga W03825 për ZPS-  
3 në dhe numri 108987 deri në 108990, dhe u pranua si 1D63.

4 Ne kemi bërë publike versionet e redaktuara të këtyre  
5 dokumenteve të cilat janë si vijon, në format të redaktuar.  
6 Është i njëjti dokument, por i redaktuar, siç e thashë. Dhe  
7 thjesht donim të informonim Gjykatën për këtë çështje.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, doni që  
9 kjo t'i vihet listës së provave materiale?

10 Z. KEHOE: [Përkthim] Ajo që kemi bërë është, Gjyqtar, që  
11 ka patur disa informacione në këto dokumente të cilat Palët  
12 Mbrojtëse si edhe Prokuroria dëshironin që të ishin të  
13 redaktuara. Pra janë thjesht prova materiale të redaktuara.

14 [Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emmerson.

16 Z. EMMERSON: [Përkthim] Nëse mund të kalojmë në seancë  
17 private, ju lutem, për këtë çështje sepse nuk mendoj që në  
18 lidhje me përvojën që patëm që do të ishte delikate dhe të mos  
19 trajtohet në seancë publike, ju lutem.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, ju lutem,  
21 na kaloni në seancë private, znj. Sekretare e Seancës.

22 [Seancë private]

23 [Seancë private teksti i fshirë]

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25



1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8 [Seancë e hapur]

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
10 jemi në seancë publike.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E mbyllim  
12 këtu seancën, do të fillojmë përsëri në orën 9.00.

13 --- Seanca mbyllet në orën 19.47

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25